# DËSHMI ARKIVI

**A-437567**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Peka: 15 makina me emigrantë janë bllokuar në Mal të Zi! Thuhet se është kërkesë nga qeveria Rama \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/11/peka-15-makina-me-emigrante-jane-bllokuar-ne-mal-te-zi-thuhet-se-eshte-kerkese-nga-qeveria-rama/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 19:53:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 19:51:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `69eb1593d3a7a5eda310ae9341a77837be11c22a768033c1a2ee472d01e8b71b` |
| TEKSTI | `7c92f14d753e03e922c0076f13c2c85dd214ba9070001c7cb4234befaac5fa3a` |
| PAMJA | `62971dbde8e24a4d2a64f1b7b485ccca19baf93912661052397a72c28078b74e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9143584b1b2f3772c613c7f58bbe5b1463997ea24d5f7def1f594fddfb62ab35` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `31f34dd8b5054bce377d5d464bdfac48435b1a3c1e78c0f9bdce1a389d75132b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9143584b1b2f3772c613c7f58bbe5b1463997ea24d5f7def1f594fdddfb62ab35`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Peka: 15 makina me emigrantë janë bllokuar në Mal të Zi! Thuhet se është kërkesë nga qeveria Rama

21:51 : 11/09/2026 në **AKTUALITET**, **POLITIKE**



Eksperti për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Avenir Peka i ftuar në "Review", pretendon se rreth 15 makina me emigrantë shqiptarë të nisur nga Anglia janë bllokuar dhe rrethuar nga policia e Malit të Zi në pikën kufitare.

Sipas tij, policia malazeze u ka komunikuar jozyrtarisht emigrantëve se ndalimi po bëhet me kërkesë të qeverisë shqiptare.

*"Janë rreth 15 makina me emigrantë që po vijnë për protestën nesër. Janë nisur nga Anglia dhe, sipas informacionit që kam, qeveria e Malit të Zi ka nxjerrë rreth 50-60 policë. Unë i kam edhe videot këtu, sepse m'i dërguan pak më parë.*

*I dërguan ata të cilët janë duke ardhur, emigrantët. Emigrantët i kanë bllokuar, i kanë rrethuar dhe nuk i lënë të lëvizin. U kanë thënë jozyrtarisht se "kemi urdhër nga…", pra se është kërkesë nga qeveria e Shqipërisë.*

**Lexo edhe:**

"Unë jam trajneri, zgjedh kush do luajë", Rama tregon si i zgjedh ministrat

Denoncimet e Ahmetajt/ Rama: Kisha investuar në një maskë karnavalesh

*Tani, meqë po flasim, se kjo është puna e Ministrisë së Brendshme të Malit të Zi, pyetja këtu është: kërkesën Malit të Zi kush e ka bërë? Ministri në ikje, ministri në ardhje apo kryeministri?*

*Më vjen keq që qeveria e Malit të Zi përfshihet, se kështu është përfshirë në politikën e brendshme të Shqipërisë"*, tha ai.

Ndërkaq, Peka i bën thirrje ambasadës dhe qeverisë së Malit të Zi që të mos ndërhyjnë në politikën e brendshme të Shqipërisë, dhe të lirojnë qytetarët shqiptarë.

*"Meqë jemi në media, unë gjej rastin t'i bëj thirrje ambasadës së Malit të Zi këtu dhe qeverisë së Malit të Zi, duke u thënë: mos i fusni hundët aty ku nuk ju takon! Është çështje e politikës së brendshme të Shqipërisë. Është detyrë e juaja, edhe si vend fqinj, edhe si*

## TË GJITHA


Peka: 15 makina me emigrantë janë bllokuar në Mal të Zi! Thuhet se është kërkesë nga qeveria Rama
21:51 : 11/09/2026


"Unë jam trajneri, zgjedh kush do luajë", Rama tregon si i zgjedh ministrat
21:41 : 11/09/2026


Denoncimet e Ahmetajt/ Rama: Kisha investuar në një maskë karnavalesh
21:22 : 11/09/2026


Situata e zjarreve/ 5 vatra mbeten aktive
21:11 : 11/09/2026


Vuçiç: Do të jap dorëheqjen në shtator
20:47 : 11/09/2026


"Nuk do bëhem mbret", Rama: Ja kur do të largohem nga posti i kryeministrit
20:46 : 11/09/2026


Ndryshimet në qeveri/ Dervishi: Siguria është përmirësuar kudo, përveç një zone...
20:28 : 11/09/2026

*politikës së jashtme të Shqipërisë. Është detyrë e juaja, edhe si vend fqinj, edhe si nënshkrues të marrëveshjes së lëvizjes së lirë midis dy vendeve, edhe si pjesë e lëvizjes së lirë në kuadrin e lëvizjes në zonën Schengen: lironi shqiptarët!*

*Sepse nuk i intereson askujt që të cenoni marrëdhëniet midis dy shteteve e dy popujve. Edi Rama sot është, nesër s'është. Mos e shkelni edhe ligjin ndërkombëtar, edhe detyrimin që keni ndaj Bashkimit Evropian. Lironi qytetarët, të mos bëheni pjesë e urdhrave të paligjshëm ose kërkesave të paligjshme.*

*Atje nuk janë protestues, atje janë qytetarë që kalojnë. Nuk kanë asnjë rrezik as për Shqipërinë, as për Malin e Zi, sepse ata në Mal të Zi nuk kanë vajtur me armë, dhe nuk ka arsye pse të ndalohen"*, shton eksperti.

Peka vuri në dukje gjithashtu praninë e forcave të shumta policore në anën malazeze. Ai nëvizoi se qytetarët nuk përbëjnë asnjë kërcënim për sigurinë.

*"Unë i kam videot: qytetarët janë në makinat e tyre, nuk i kanë lënë të dalin nga makinat e tyre. Më keq akoma. Është bërë një gardh prej 50-60 policësh. Gardh pse duhet të bësh në pikëkalim?*

*Është te zona në anën e Malit të Zi, nuk është te ana e Bosnjës. Pretendojnë që policët u kanë thënë se "është kërkesë nga qeveria e Shqipërisë".*

*Çfarë do të bëjnë? Do t'i mbajnë atje, t'i kthejnë mbrapsht? Se s'kanë çfarë të bëjnë. Është e kotë"*, tha eskperti Avenir Peka.

**Etiketa:** Edi Rama emigrante mali i zi proteste

## Lajme të lidhura



**"Unë jam trajneri, zgjedh kush do luajë", Rama tregon si i zgjedh ministrat**
21:41 : 11/09/2026



**Denoncimet e Ahmetajt/ Rama: Kisha investuar në një maskë karnavalesh**
21:22 : 11/09/2026



**"Nuk do bëhem mbret", Rama: Ja kur do të largohem nga posti i kryeministrit**
20:46 : 11/09/2026



**Ndryshimet në qeveri/ Dervishi: Siguria është përmirësuar kudo, përveç një zone...**
20:28 : 11/09/2026



**Denoncimi i shqiptarit nga diaspora: Jemi bllokuar në Mal të Zi me urdhër të Ramës**
20:16 : 11/09/2026



**Rama: Në jetë më kanë dhunuar vetëm dy herë, më lanë për të vdekur...**
18:38 : 11/09/2026


BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.